



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot. 220
Df. 24.03.21

Vendim nr. 23 datë 24.03 2021

Për miratimin e *kontratës-tip* për të drejtat e autorit për
pjesëmarrësit në projektet madhore
të Akademisë së Shkencave

1. Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 24 mars 2021, miratoi *kontratën-tip* (bashkëngjitur) për format e bashkëpunimit dhe mënyrën e shpërblimit të *autorëve pjesëmarrës / bashkëpunëtorëve pjesëmarrës* në hartimin e botimin e veprave madhore në albanologji, që financohen me buxhet shtetëror për një periudhë 2-4-vjeçare.
2. Ngarkohen QBAE dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA) që, brenda datës 5 prill 2021, të paraqesin *listën e plotë të autorëve pjesëmarrës* për veprat madhore *Fjalor i madh i gjuhës shqipe* dhe *Histori e shqiptarëve*; si dhe *listën e plotë të bashkëpunëtorëve pjesëmarrës* (kontribuues për pjesë të veçanta të dy veprave, këshillues shkencorë, anëtarë të redaksive, redaktorë gjuhësorë e shkencorë, recensues).
3. Ngarkohet drejtori i QBAE për nënshkrimin e kontratës me *autorët pjesëmarrës* dhe me *bashkëpunëtorët pjesëmarrës* në dy veprat madhore *Fjalor i madh i gjuhës shqipe* dhe *Histori e shqiptarëve*.
4. Ngarkohen kancelari, juristi dhe sektori i financës të ndjekin ushtrimin e buxhetit sipas vendimit të themelimit të QBAE.
5. Ngarkohet sekretari shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

